



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e regullt të mbajtur më 12.08.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Sistemimin dhe Procedimin e Materialeve Zgjedhore gjatë Paketimit

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore, për sistemimin dhe procedimin e materialeve zgjedhore gjatë paketimit.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 12.08.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Departamenti i Operacioneve zgjedhore

Divizioni i trajnimit

Rekomandime për sistemimin dhe procedimin e materialeve zgjedhore gjatë paketimit

Duke u bazuar në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale në Republikën e Kosovës dhe rregullën zgjedhore 09/2013, Neni 21 paragrafi 18 i përcakton procedura në të cilat duhet bazuar procesi i numërimit dhe paketimit të materialeve Ditën e Zgjedhjeve. Doracaku i Procedurave të votimit dhe numërimit është dokument që përmban përshkrimin e detajuar të të gjitha procedurave të aplikueshme ditën e zgjedhjeve, në bazë të të cilave funksionojnë Këshillat e Vendvotimeve.

Dokumenti në vazhdim, përmban rekomandimet të cilat kanë për qëllim, verifikimin dhe sigurimin e të dhënave të cilat evidentohen në procesin e numërimit të votave të kandidatëve të SP në Vendvotim dhe thjeshtëzimin e Procedurave të paketimit.

Rekomandimet e dhëna kanë të bëjnë me katër materiale zgjedhore:

1. Ngjyra e padukshme (spreji)
2. UV Llamba dhe
3. Fletët llogaritëse të votave të kandidateve dhe
4. Materialet administrative në vendvotim

Për materialet në fjalë, është bërë përshkrimin i procedurave të cilat deri më tani janë aplikuar për sistemimin dhe kategorizimin e këtyre materialeve Ditën e Zgjedhjeve, rekomandimeve për ndryshim dhe arsyeshmerine e ndryshimeve. Rekomandimet e dhëna prekin procedurat e numërimit dhe paketimit të materialeve zgjedhore në VV të cilat me tutje procedohen në KKZ dhe më pastaj në QNR.

1. Ngjyra e padukshme (Spreji)

- Ngjyra e padukshme është material i ndjeshëm i cili ditën e zgjedhjeve së bashku me materialet e tjera të ndjeshme i dorëzohet Kryesuesit të Këshillit të vendvotimit.
- Ky artikull përmes spërkatjes së gishtërinjve dhe shenjave që lenë, shërben për të siguruar se votuesi ka votuar njëherë.

- Pas mbarimit të procesit të votimit artikulli në fjalë e humbë rëndësinë për çka është destinuar gjate ditës së zgjedhjeve.
- Në proceduar e deritanishme të paketimit, ky artikull është paketuar në kutitë e votimit me të gjitha materialet tjera të ndjeshme të cilat dorëzohen në KKZ.
- Gjendja kimike e këtij materiali është e lëngët.

Rekomandim:

Duke u bazuar si më lartë , funksioni i këtij artikulli nuk është i vlerës se njëjtë si para fillimit të procesit të votimit edhe ne procesin e paketimit. Jo ndjeshmëria dhe gjendja e lëngët e këtij artikulli, konsiderojmë se nuk do të duhej të mbetet në kutinë e votimit e cila përmban materialet e ndjeshme të ditës së zgjedhjeve të cilat dorëzohen në KKZ.

Largimi e këtij materiali nga kutia ku paketohen materialet e ndjeshme, do të ndikoj ne thjeshtëzimin e procedurave të paketimit dhe ruajtjen nga dëmtimet e mundshme te materialeve të ndjeshme ne Kutitë e votimit Ditën e Zgjedhjeve.

2. UV Llamba

- Ky artikull gjatë procesit të votimit shërben për të bërë identifikimin e shenjave të uv sprejit në gishtërinj.
- Ky material gjatë procesit të paketimit hynë në kutinë e votimit se bashku me materialet tjera të ndjeshme.

Rekomandim:

Si më lartë, artikulli në fjalë nuk është i rëndësisë si materialet tjera të ndjeshme në kutinë e votimit e cila dorëzohet ne KKZ. Me qellim te thjeshtëzimit të procedurave të paketimit dhe mundësisë që ky artikull të mund te shfrytëzohet prapë , rekomandojmë që mos të paketohet në kutinë me materialet tjera të ndjeshme.

3. Fletët llogaritëse të kandidatëve të SP (FLLK)

Ky material është i një rëndësie të veçantë në procesin e numërimit në vendvotim.

Përshkrimet në vijim përmbajnë procedurat të cilat aplikohen në vendvotim gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatëve dhe paketimit:

- Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV, janë përgjegjës të numërojnë votat e kandidatëve dhe ti regjistrojnë/shkruajnë në Formularin e përputhjes së rezultateve për kandidat (FRK).
- Kryesuesi nxjerrë materialet e nevojshme siç janë: Formulari i votave të kandidatëve, Fletët që shërbejnë për regjistrim të votave të kandidatëve (FLLK), stilolapsat e kaltër;
- Rifreskon procedurat dhe sqaron në detaje si do të përdoren;
- Kryesuesi cakton dy (2) anëtarë si LEXUES dhe dy(2) si REGJISTRUES për ti shkruar votat ne FLLK;

- Kryesuesi udhëzon ekipin ti rendisin fletëvotimet në dengje me nga 25;
- Votat do të lexohen nga një lexues, ndërsa dy (2) regjistruer do të shkruajnë votat në FLLK;
- Pas përfundimit të dengut(25) Kryesuesi krahason a përputhen votat e kandidatëve në të dy FLLK.
- Nëse gjendet mospërputhje e fletëvotime, dengju me 25 fletëvotime i delegohen dhe lexohen nga lexuesi i dytë (2);
- Kryesuesi pas përfundimit të numërimit të votave për secilin kandidat, shumen totale e bartë në FRK.
- Pas përfundimit të numërimit dhe përgatitjes për paketim Kryesuesi siguron që :
 - Çdo fletë llogaritëse duhet të ketë të plotësuar: Emrin dhe numrin e Subjektit Politik;
 - Çdo Fletë llogaritëse e përdoruar duhet të jetë e nënshkruar nga regjistruesi, si dhe të përmbajë emrin dhe mbiemrin e regjistruesit me shkronja të shtypit.

Rekomandim:

Për arsye të mënjanimi të parregullsive , mospërputhjeve që ndodhin në procesin e numërimit të votave të Kandidatëve dhe thjeshtëzimin e procedurave të paketimit, rekomandojmë propozimet si në vijim:

- Pas përfundimit të leximit të fletëvotimeve për kandidatët, regjistrimit të vota në Fletët llogaritëse dhe krahasimin e tyre, Kryesuesi, dy regjistruerit dhe lexuesi janë të obliguar të shkruajnë emrin dhe mbiemrin me shkronja të shtypit dhe të nënshkruhen në të dy FLLK; (**shih mostrat në formën zgjedhore nr. 303**)
- Kryesuesi i VV duhet të shkruaj në Librin e votimit emrat e dy regjistruerëve;
- Fletët e përdorura llogaritës për Votat e kandidatëve, gjatë paketimit, një kopje mbetet brenda Kutisë, ndërsa kopja tjetër ti bashkëngjitet Zarfit të KKZ (**shih formën zgjedhore Nr. 304**) i cili dorëzohet në KKZ;
- Fletët llogaritëse të paplotësuar të mos mbesin në kutinë e votimit me materialet tjera të ndjeshme, por të kthehen në KKZ me materialet tjera jo të ndjeshme. Këto fletë llogaritëse mund të shfrytëzohen edhe për procese tjera.

4. Materialet administrative në Vendvotim

Rekomandim:

Te gjitha materialet administrative të cilat deri me tani janë paketuar në kutitë e votimit me materiale të ndjeshme, tash e tutje të paketohen në qese të veçanta si material i pandjeshëm i cili dorëzohet në KKZ.

Andaj, korrigjimet si më lartë, konsiderojmë se do të na ndihmojnë në zhvillimin e një procesi shumë transparent të numërimit dhe thjeshtëzimit e procedurave të pranim-dorëzimit të materialeve ditën e zgjedhjeve në cilën do instance, si në KKZ ashtu edhe në QNR.

Rekomandimet e dhëna i kemi ilustruar edhe në format zgjedhore të procedurave të duhura , për të pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar format me dizajnët e reja në bazë të propozimeve të dhëna.